



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 681/ prot.

Pukë, më 23.04 2026

RELACION

Mbi

PROJEKT VENDIMIN

Nr. 07, datë 23.04 2026

“PËR

SHPALLJEN E DATËS 3 MAJ TË ÇDO VITI SI FESTË LOKALE ‘KORTHPULA BEKON’,
NË FSHATIN KORTHPULË, NJËSIA ADMINISTRATIVE LUF-QERRET”

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Ky projektvendim paraqitet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Bashkisë Pukë, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në veçanti të nenit 25, i cili përcakton funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese, si dhe në funksion të përmbushjes së objektivave për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, shpirtërore dhe historike, forcimin e identitetit lokal dhe nxitjen e kohezionit social në komunitet.

Nisma për shpalljen e datës 3 Maj si festë lokale tradicionale me emërtimin “Korthpula Bekon” vjen si propozim i Kryetarit të fshatit Korthpulë, Njësia Administrative Luf-Qerret, bazuar në kërkesat e vazhdueshme të komunitetit vendas dhe në rëndësinë e veçantë që kjo datë përfaqëson për banorët e kësaj zone.

Data 3 Maj përkon me një traditë të hershme fetare dhe historike, të lidhur ngushtë me përkujtimin e “Shen Kryqit”, e cila daton që nga ndërtimi i kishës së fshatit në vitin 1632. Kjo ditë është shndërruar ndër vite në një moment të rëndësishëm bashkimi shpirtëror dhe komunitar, ku banorët e zonës dhe ata të larguar rikthehen për të marrë pjesë në ritualet fetare, meshën e shenjtë dhe aktivitetet tradicionale.

Shpallja e kësaj date si festë lokale synon institucionalizimin e një tradite të konsoliduar ndër breza, duke i dhënë asaj një status zyrtar dhe duke garantuar vijimësinë e saj si pjesë e identitetit kulturor të zonës. Ky hap është në përputhje të plotë me politikat vendore për ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore, si dhe për promovimin e vlerave qytetare dhe të bashkëjetesës në komunitet.

Gjithashtu, kjo festë përbën një mundësi konkrete për zhvillimin e jetës sociale dhe kulturore në territor, duke nxitur pjesëmarrjen qytetare, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe promovimin e zonës si një hapësirë me vlera të veçanta historike e tradicionale. Përmes organizimit të

aktiviteve të lidhura me këtë ditë, pritet të rritet ndërgjegjësimi për ruajtjen e traditave, si dhe të forcohen lidhjet ndërmjet brezave dhe komunitetit.

Në këtë kuadër, Bashkia Pukë, në bashkëpunim me Njësinë Administrative Luf-Qerret, institucionet fetare dhe komunitetin lokal, do të luajë një rol aktiv në organizimin dhe mbështetjen e kësaj feste, duke e kthyer atë në një aktivitet të qëndrueshëm me ndikim pozitiv në jetën sociale dhe kulturore të zonës.

Për sa më sipër, vlerësohet se miratimi i këtij projektvendimi është i nevojshëm dhe në përputhje të plotë me funksionet dhe përgjegjësitë e Bashkisë, si dhe me interesin e komunitetit lokal.

Duke qenë se ky propozim reflekton një kërkesë të ligjshme dhe të konsoliduar të komunitetit të Korthpulës, propozohet miratimi i projektvendimit nga Këshilli i Bashkisë Pukë.

Bashkëlidhur projektvendimi përkatës.

Përgatiti relacionin

DREJTORI I DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SOKOL GJONI



07.04.26

S. Spary
Këshilli Bashkisë
Korthpulë
Përfaqësues

Korthpulë, më, 07.04.2026

KËRKESË

Lënda: Shpallje ditë feste lokale të datës 3 Maj për fshatin Korthpulë.

Drejtuar:

Bashkisë Pukë

KESHILLIT BASHKISË PUKË



Nisur nga kërkesat e vazhdueshme të banorëve të fshatit Korthpulë kërkohet që data 3 Maj (SHEN KRYQI) Të zyrtarizohet festë lokale pasi kjo datë historikisht ka qenë dhe është festë përkujtimore fetare me pjesmarrje masive të banorëve.

Kisha e fshatit është pagëzuar me emrin kasha e SHEN KRYQIT e ndërtuar në vitin 1632.

3 Maji është ritual i përvitshëm përkujtimor me bekimin e kryqit, MESHEN E SHENJTË nga çdo korthpulas kudo që të jetë me banim.

Ky bashkim duke qenë i mirëorganizuar në bashkëpunim me KLERIN KATOLIK do e bëjë 3 Majin madhështor e më festiv.

Me slloganin "KORTHPULA BEKON", kjo datë do të jetë e përvitshme, do ruaj traditën, do të ruaj harmoninë dhe shoqërinë e mirë.

Këshilli i Bashkisë si organ përfaqësues i interesave të qytetarëve me vendimin për shpalljen e 3 MAJIT festë lokale të Korthpulës, do t'i bëjë një shërbim të shkëlqyer promovimit të vlerave dhe resurseve të kësaj zone me mjaft histori.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, mbetemi në pritje të plotësimit të kërkesës sonë.

Kryetari i fshatit Korthpulë

Gjovalin HERCEKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 681 prot.

Pukë, më 23.04.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 07, datë 23.04.2026

PËR

SHPLLJEN E DATËS 3 MAJ TË ÇDO VITI SI FESTË LOKALE “KORTHPULA BEKON”, NË FSHATIN KORTHPULË, NJËSIA ADMINISTRATIVE LUF-QERRET”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 25 “*Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese*”, si dhe në përputhje me objektivat për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, shpirtërore dhe historike, forcimin e identitetit lokal, nxitjen e solidaritetit komunitar dhe zhvillimin e veprimtarive me karakter social, kulturor dhe tradicional, Këshilli i Bashkisë Pukë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Shpalljen e datës 3 Maj të çdo viti si festë lokale tradicionale me emërtimin “Korthpula Bekon”, në fshatin Korthpulë, Njësia Administrative Luf-Qerret.
2. Kjo festë organizohet në përkujtim të traditës fetare dhe historike të zonës, në nder të “Shen Kryqit”, si dhe në funksion të ruajtjes dhe promovimit të vlerave kulturore, shpirtërore dhe komunitare të banorëve të Korthpulës.
3. Bashkia Pukë, në bashkëpunim me Njësinë Administrative Luf-Qerret, institucionet vendore dhe komunitetin, merr masat për organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve përkatëse në kuadër të kësaj feste.
4. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

Paraqitën projektin;

Drejtori i Menaxhimit të BNJ.

Sokol Gjoni

Juristi

Aida Sinani

Kryetari

Rrok Dodaj

